

**Lënda:** Problematikat e administrimit të QKK-së dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e kinematografisë shqiptare

**Drejtuar:** Z. Blendi Gonxhja,

Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

I nderuar Z. Blendi Gonxhja,

Krijimi i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, është mirëpritur nga komuniteti i kineastëve si një strukturë tepër e rëndësishme për zhvillimin e kinematografisë dhe audiovizualit në Shqipëri. Bashkimi i këtyre fushave të përgjegjësisë nën një dikaster të vetëm është një hap premtues që mund të sjellë përfitime të konsiderueshme për sektorin tonë.

Gjatë vitit të parë të mandatit tuaj në drejtim të MEKI, komuniteti i kineastëve ka pasur dëshirën të ndajë me ju vizionin, mendimet dhe propozimet e profesionistëve të fushës për zhvillimin e sektorit të kinematografisë dhe audiovizualit, si pjesë e rëndësishme e kulturës dhe ekonomisë kreative.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK) përfaqëson një nga investimet më fitimprurëse për kulturën shqiptare. Duke qenë se çdo lek i investuar në kinematografi gjeneron një kthim 5-fish të investimit, QKK-ja shërben si katalizator për një sektor që unikisht ndërthur tre shtylla kryesore: ekonominë, kulturën dhe inovacionin. Si institucioni kryesor që drejton këtë fushë në Shqipëri, QKK-ja është thelbësore jo vetëm për komunitetin e filmit, por për të gjithë ekosistemin audiovizual dhe trashëgiminë kulturore të vendit, duke e vendosur Shqipërinë në hartën e industrisë kreative në botë.

Komuniteti i kineastëve, ka ndjekur me vëmendje të veçantë veprimtarinë dhe zhvillimet në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë. Gjatë kësaj periudhe, kemi shprehur vazhdimisht mendimet dhe sugjerimet tona lidhur me politikat dhe vendimmarrjet e QKK-së, por fatkeqësisht komunikimi me institucionin nuk ka qenë në nivelin e duhur. Megjithëse procesi i emërimit të drejtuesit të QKK, Z. Eol Çashku, ka pasur momentet e veta të diskutueshme, ne shprehim gatishmërinë për të bashkëpunuar në mënyrë konstruktive për të siguruar funksionimin optimal të institucionit.

Ditët e fundit, konkretisht me datë 10.01.2025, QKK ka njoftuar hapjen e konkurseve për 3 pozicione vakante. Ky zhvillim na shtyn të ndajmë me ju disa vëzhgime dhe shqetësime serioze lidhur me funksionimin e institucionit gjatë 10 muajve të fundit nën drejtimin e Z. Eol Çashku. Këto shqetësime përfshijnë:

## **I. MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT:**

### **1. Rekrutimi i stafit të QKK-së**

Burimet njerëzore përfaqësojnë vlerën më të çmuar të çdo institucioni, veçanërisht në një institucion si Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK) ku kërkohet një ekspertizë e thelluar. Pavarësisht se vetë Ju si Ministër keni theksuar në mënyrë të përsëritur nevojën për rritjen e kapaciteteve të administratës, situata aktuale në QKK paraqet shqetësime serioze për cilësinë e shërbimit që do të ofrohet.

Aktualisht, QKK ndodhet në një situatë disfunktionale që pritet të vazhdojë për disa muaj. Më konkretisht, sipas njoftimit zyrtar, **më 20 janar 2025 pritet të përzgjidhen për të tretën herë brenda vetëm tre muajve (Tetor 2024 – Janar 2025) tre pozicione kyçe: Drejtori i Drejtorisë së Projekteve, Përgjegjësi i Sektorit të Financës, dhe Juristi.** Ky qarkullim i shpeshtë i stafit është një tregues i qartë i problemeve themelore në menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit.

Kriteret e vendosura për këto pozicione ngrënë shqetësime të mëtejshme. Ato jo vetëm që janë jashtë profilit real të punës, por afatet tejet të shkurtra për paraqitjen e kandidaturave (5 ditë kalendarike) krijojnë një dyshim të arsyeshëm se edhe kandidatët e rinj mund të përfundojnë në të njëjtën situatë - duke mos e kaluar periudhën e provës. Kjo do të thellojë më tej ciklin e paqëndrueshmërisë në institucion.

Duhet theksuar se QKK, edhe pse ka vetëm 9 punonjës, luan një rol vendimtar në fushën e kinematografisë. Specifika e prodhimit të filmit kërkon një memorie të fortë institucionale dhe një transmetim të vazhdueshëm të ekspertizës ("zanatit") mes brezave të punonjësve. Kjo është thelbësore për mbarëvajtjen dhe funksionimin efektiv të institucionit.

Pasojat e kësaj situate janë të prekshme dhe të matshme: pritet që QKK të pësojë vonesa të konsiderueshme 4-6 mujore në përmbushjen e detyrimeve të saj institucionale. Këto vonesa jo vetëm që ndikojnë në performancën e institucionit, por kanë një efekt domino në të gjithë sektorin e kinematografisë në vend.

Kjo situatë kërkon një ndërhyrje të menjëhershme për të rishikuar politikën e rekrutimit, për të përshtatur kriteret me kërkesat reale të pozicioneve, dhe mbi të gjitha, për të krijuar kushtet e nevojshme për mbajtjen dhe zhvillimin afatgjatë të stafit profesional në QKK.

### **2. Miratimi i Rregullores së Përgjithshme e Mbështetjes Financiare dhe Lejeve nr. 168 Prot., datë 27.05.2024**

Ky është një akt administrativ, që ka sjellë disa problematika. Përveç konfuzionit që krijon, përmban norma përjashtuese dhe në këtë mënyrë kufizon konkurrencën e lirë, sidomos për produksionet e reja dhe regjisorët e rinj. Si e tillë, kjo rregullore penalizon dy nga tre shtyllat kryesore të projekteve kinematografike dhe krijon të gjitha mundësitë për të përjashtuar nga gara regjisorët dhe producentët e rinj.

Në Rregullore janë ngritur barriera artificiale ku vëmë re me shqetësim piken d, Neni 2, Kapitulli V. Askush nga ne, nuk ka hasur kurrë kërkesën për diplomë regjisorit për filmat e metrazhit të gjatë në të gjitha organizmat ndërkombëtare që kemi aplikuar dhe për të cilat jemi mbështetur. Gjithashtu, nuk lihet asnjë hapësirë konkurimi për regjisorët që kanë studiuar regji dhe kanë marrë mbështetje financiare për vepra filmike. Duke kufizuar të drejtën e konkurimit vetëm me degën Regji Filmi, diskriminohet dhe përjashtohet nga gara një brez i tërë regjisorësh.

Barriera artificiale janë ngritur edhe për regjistrimin e producentëve të rinj. Si një sipërmarrje e lirë, çdokush ka të drejtë të hapë biznes në fushën që preferon, përfshi edhe produksionin filmi apo audiovizual. Kriteret e vendosura në Rregullore bien në kundërshtim me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, duke frenuar iniciativën e lirë të sipërmarrjes.

Këto problematika janë bërë prezente me reagime nga shoqatat e kineastëve, apo dhe producentë, por me arrogancë nuk janë marrë në konsideratë nga Kryetari i QKK, madje as nuk ka kthyer përgjigje zyrtare.

### **3. Administrimi i buxhetit të QKK-së, i cili paraqet shqetësime serioze:**

Ndërkohë që pranojmë se mbartja e buxhetit mund të jetë një domosdoshmëri për funksionimin e vazhdueshëm të institucionit, kjo kërkonte një proces më të strukturuar dhe transparent.

**Megjithëse Ministria e Financave ka konfirmuar zyrtarisht më shumë se një herë për pamundësinë e implementimit të nenit 5 të ligjit “Për kinematografinë”, me një këmbëngulje të pa logjikshme, u bllokua aktiviteti kryesor i QKK jashtë të gjitha limiteve kohore.** Për pasojë, vendimmarrja për mbështetjen financiare të projekteve të reja që duhet të bëhen gjatë një viti financiar u bënë për 2 javë, duke shkelur çdo afat të mundshëm të përcaktuar në Rregulloren e Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve nr. 168 Prot., datë 27.05.2024, të miratuar nga vetë z. Çashku. Shkelja e afateve është pasojë minimaliste, po të marrësh në konsideratë faktin që i ndodhur nën presionin e djegies së buxhetit, nëpërmjet mbledhjeve urgjente, u miratuan projekte dytësore, të cilët u financuan me buxhet deri 150 % nga projektet paraardhëse të të njëjtës gjini. Ndërsa që projektet e metrazhit të gjatë me autorë regjisorët shqiptarë të karrierës, projektet e të cilëve mbajnë peshën kryesore të bashkëprodhimeve, distribucionit dhe promocionit të kulturës shiptare në botë, të cilat u shpallën fitues në muajin tetor 2024, u përballën me ulje të konsiderueshme të buxhetit, ndërkohë që dihet mirë sa është niveli i financimeve të filmave të gjatë në rajon dhe Evropë, por edhe sa janë rritur kostot e prodhimit të këtyre projekteve.

Idea tjetër e çuditshme ishte këmbëngulja nga ana e Kryetarit që buxhetin e QKK për projektet fituese ta kalojë në një bankë të nivelit të dytë. Nuk dimë një rast të ngjashëm, që një institucion buxhetor të mbartë buxhetin dhe ta konservojë atë në një bankë të nivelit të dytë, duke anashkaluar çdo institucion kontrollues financiar dhe duke lënë hapësira për abuzime.

**Pas miratimit të Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve nr. 168 Prot., datë 27.05.2024, shoqatat e kineastëve ju përgjigjën menjëherë kërkesës së z. Çashku dhe në datën 06.06.2024 u kryen procedurat dhe u krijuan Këshillat Miratues të Projekteve. Mosveprimi i Kryetarit për hapjen e thirrjeve për projekte për 6 muaj, megjithë kërkesat tona, tregon mungesën e një plani të qartë strategjik dhe financiar, e cila ka çuar në mosshfrytëzimin efektiv të një pjese të konsiderueshme të buxhetit të vitit 2024, për të cilin komuniteti i kineastëve ende nuk ka asnjë informacion zyrtar për situatën e buxhetit të ezauruar.**

#### **4. Shkelja e paprecedente e një prej parimeve kryesore që garanton ligji “Për kinematografinë”- KONKURENCA.**

Shkelja e parimit bazë të konkurimit, duke i financuar të gjithë projektet në garë. Në periudhën 10 mujore në detyrë, z. Çashku ka hapur 3 thirrje për konkurse për gjithsej 9 kategori projektesh. **Kanë marrë pjesë në konkurim gjithsej 43 projekte dhe janë miratuar 35 projekte, pra janë miratuar 82% e projekteve konkuruuese. Në 7 konkurse janë miratuar të gjithë projektet pjesëmarrëse në garë, madje është zhvilluar mbledhja edhe kur në “garë” ka pasur vetëm 1 projekt në konkurim.**

Në mbledhjet e KMP-ve të zhvilluara në datat 19-24 dhjetor 2024, kanë aplikuar gjithsej 23 projekte dhe janë financuar 18 prej tyre. “Seleksionimi” është bërë vetëm për projektet për filma artistikë të metrazhit të shkurtër, ku konkurojnë regjisorët e rinj.

Kjo ka sjellë keqmenaxhim të buxhetit, uljen e cilësisë dhe hapësira për abuzime financiare apo klienteliste.

#### **5. Vonesa e pajustificuar në hapjen e konkursit për filmat artistikë vepër e parë dhe e dytë:**

**Ky konkurs nuk është zhvilluar për afro 4 vite, duke penguar zhvillimin profesional të një brezi të tërë kineastësh.**

Aktualisht, mbi 20 regjisorë të rinj dhe të moshës së mesme presin mundësinë për të konkuruar në këtë kategori. **Disa projekte të kësaj kategorie janë zhvilluar me financime të organizatave europiane të filmit, si Creative Europe fondi i zhvillimit, me të cilët kanë nënshkruar kontrata me afate të përcaktuara për fazat e xhirimit dhe realizimit të premierave.** Për shkak të mungesës së hapjes së garës në këtë kategori producentët jo vetëm janë përballur me penalitete financiare, por kjo vë në dyshim edhe seriozitetin e producentëve apo edhe shtetit shqiptar përkrah donatorëve, dhe kompanive bashkëprodhuese.

Kjo kategori është veçanërisht e rëndësishme pasi:

- i. Përfaqëson një nga shtyllat kryesore të rinovimit të kinematografisë shqiptare;
- ii. Përfshin regjisorë me potencial të lartë krijues dhe inovativ;
- iii. Është thelbësore për vazhdimësinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të

- kinematografisë vendase;
- iv. Kontribuon në diversifikimin e zërave artistikë në kinematografinë shqiptare.

Vonesa në hapjen e këtij konkursi rrezikon të shkaktojë një boshllëk të konsiderueshëm në zhvillimin e kinematografisë shqiptare dhe të dekurajojë një brez të tërë kineastësh të talentuar.

## 6. Performanca institucionale:

Mungesa e kuadrit ligjor, veçanërisht në fushën e stimujve tatimorë (tax incentives) dhe ligjit të audiovizualit, po pengon zhvillimin e sektorit të filmit në Shqipëri. **Situata përkeqësohet nga komunikimi jo i saktë rreth politikave fiskale, ku deklaratat se "Shqipëria është tax free për filmin" nuk pasqyrojnë realitetin dhe krijojnë konfuzion në komunitetin ndërkombëtar.** Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme nga komuniteti i kineastëve për stimuj tatimorë, çështja nuk ka marrë vëmendjen e duhur institucionale. Me implementimin e duhur të këtyre mekanizmave, Shqipëria mund të tërheqë investime vjetore prej 20-30 milionë eurosh, duke sjellë përfitime në shumë sektorë si industria audiovizuale, turizmi, transporti dhe hoteleria.

Stimujt tatimorë konsiderohen thelbësorë për:

- i. Zhvillimin e industrisë vendase të filmit
- ii. Tërheqjen e produksioneve të huaja
- iii. Gjenerimin e të ardhurave në ekonomi
- iv. Përshtatjen me praktikatat e vendeve të zhvilluara në këtë sektor

Situata kërkon ndërhyrje të menjëhershme për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të sektorit.

## 7. Mungesa e përcaktimit të ndarjes së buxhetit për çdo gjini filmi.

Aktualisht nuk ekziston një ndarje e qartë dhe transparente e buxhetit për çdo gjini filmi, që:

- i. Krijon paqartësi në planifikimin e projekteve nga kineastët;
- ii. Vështirëson procesin e aplikimit për financim;
- iii. Pengon zhvillimin e balancuar të të gjitha gjinive filmike;
- iv. Nuk garanton shpërndarje të drejtë të fondeve.

Kjo problematikë kërkon:

- i. Përcaktimin e kriterëve të qarta për ndarjen e buxhetit sipas gjinive;
- ii. Publikimin paraprak të buxheteve për çdo kategori filmike;
- iii. Transparencë në procesin e shpërndarjes së fondeve;
- iv. Garanci për mbështetjen e të gjitha gjinive filmike sipas nevojave të tregut dhe zhvillimit të kinematografisë.

**Ulja e buxheteve të filmit të metrazhit të gjatë rezulton të jetë bërë pa asnjë logjikë ekonomike dhe asnjë studim. Shqipëria sot ka rritjen ekonomike dhe buxhetin më të lartë historik, ndërkohë që kostot kanë ndryshuar në rritje. Ndërkohë që çdo qendër filmi në rajon dhe më gjerë i ka stabilizuar buxhetet për çdo gjini të filmit, QKK bën eksperimente me ulje të buxheteve në shifrat e 1997, pa asnjë motivacion. Dhe për ironi, në ditët e fundit të vitit, në maratonën e mbledhjeve të gjiive të tjera, shpërndan gati 150 % më shumë buxhet për produkte me vlerë dytësore në kinematografi.**

Mungesa e stabilitetit të buxheteve për çdo gjini të filmit krijon vështirësi për realizimin e veprave artistike, pasiguri tek producentët dhe komunitetin e kineastëve dhe rrezikon zhvillimin e balancuar të kinematografisë shqiptare.

#### **8. Mungesa e kalendarit të planifikuar të thirrjeve për projekte:**

Konstatohet mungesën e një kalendarit vjetor të thirrjeve për projektet filmike, çka sjell:

- i. Pamundësi për planifikim afatgjatë nga kineastët;
- ii. Vështirësi në koordinimin me financime të tjera ndërkombëtare;
- iii. Pasiguri në komunitetin e filmit;
- iv. Pengesa në zhvillimin e projekteve të reja.

Një kalendar i qartë thirrjesh është i domosdoshëm për:

- i. Planifikimin efektiv të projekteve filmike;
- ii. Përgatitjen e duhur të aplikimeve;
- iii. Sinkronizimin me afatet e festivaleve dhe tregjeve ndërkombëtare;
- iv. Koordinimin me koproduksione të mundshme;
- v. Menaxhimin më të mirë të burimeve njerëzore dhe teknike.

**Mungesa e këtij kalendarit ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e projekteve dhe në mundësitë e kineastëve për të planifikuar punën e tyre krijuese.**

#### **9. Ndryshimi i Rregullores për afatet e konkurimit dhe % e financimit fillestar të projekteve të kategorisë Minority co-production**

Ndryshimi i Rregullores së Përgjithshme të Financimit dhe Lejeve me Urdhërin nr. 66, (i cili mban dy data 18 dhe 19 nëntor 2024), lidhur me:

- i. Ndryshimin e afatit të thirrjeve për aplikime. Thirrja për aplikime u hap në datën 19 nëntor 2024 dhe u mbyll në datën 5 dhjetor 2024. Producentëve dhe autorëve iu la në dispozicion për të përgatitur projektet vetëm 2 javë kohë.
- ii. Ndryshimin e masës së financimit fillestar të projekteve bashkëprodhime në minorancë (minority co-production) në 80%, nga 20% që ka qenë prej disa



vitesh. Pavarësisht se një akt juridik nuk mund të ketë fuqi prapavepruese, QKK e implementoi me “sukses të plotë” këtë shkelje.

Ligji “Për kinematografinë” bazohet në dy parime thelbësore:

- i. Mbështetje për autorët shqiptarë për të prodhuar vlera artistike;
- ii. Përzgjedhja e projekteve bëhet mbi bazën e një procesi konkurimi të hapur dhe transparent.

Kjo mbledhje shkeli pikërisht këto dy parime. Meqë nuk e mbartim dot buxhetin, anullojmë vendimet pa baza ligjore, u japim autorëve të huaj buxhet maksimal, dhe nga 6 projekte në konkurim fitojnë që të 6.

### **10. Shqetësim serioz përbën qëndrimi dhe komunikimi institucional ndaj prodhimeve të financuara nga QKK:**

Industria e kinematografisë në vend ka mbijetuar përgjatë periudhave shumë të vështira të tranzicionit. Mungesa e politikave të qarta në këtë sektor e ka ngurtësuar procesin e zhvillimit. Sjellim në vëmendjen tuaj se prodhimet shqiptare kanë arritur të pesëfishojnë buxhetin e tyre në bashkëprodhimet ndërkombëtare dhe konkurrojnë denjësisht në arenën ndërkombëtare, pavarësisht sfidave të shumta.

**Çdo njëri prej nesh është një aset i çmuar për të çuar përpara këtë industri, në vend që të jemi gjithmonë të krahasuar me ish-Kinostudion. Ne përballemi me një sektor me nivele shumë të larta konkurrence në botë, ndaj kjo mënyrë e portretizimit të përpjekjeve dhe sakrificave tona ndër vite është shumë e pavend dhe nuk ndihmon aspak në ndërtimin e një klime produktive dhe zhvilluese.**

Vërehet një tendencë sistematike për të nënvlerësuar cilësinë e filmave të mbështetur nga QKK ndër vite, çka dëmton:

- i. Imazhin e kinematografisë shqiptare;
- ii. Besimin e publikut te prodhimet vendase;
- iii. Mundësitë për promovim ndërkombëtar të filmave;
- iv. Motivimin e kineastëve për projekte të reja.

Në vend të një vizioni konstruktiv për zhvillimin e kinematografisë dhe implementimit të platformës "Nga problemet tek zgjidhjet", vërehet një qasje që:

- i. Fokusohet te kritika e pambështetur ndaj punës së kineastëve, deri në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë;
- ii. Nuk ofron zgjidhje konkrete për përmirësimin e situatës;
- iii. Mungon plani i qartë strategjik për zhvillimin e sektorit.

Konsiderojmë se roli i QKK-së duhet të jetë mbështetës dhe nxitës për zhvillimin e kinematografisë shqiptare, duke ofruar kushte dhe mundësi për rritjen e cilësisë së prodhimeve filmike vendase.

## **II. SHKELJET E AKTEVE LIGJORE DHE NËNLIGJORE ME PASOJA TË PARIKUPERUSHME DHE DËM EKONOMIK.**

### **1. Rikthimi vendimit për miratimin e projekteve të kategorisë Minority Co-production**

Këshilli i Miratimit të Projekteve, me kërkesën e Kryetarit me vendimin nr. 3/1 datë 20.11.2024 krijoi një precedencë antiligjore dhe absurde, në shkelje flagrante të nenit 9 paragrafi 1 dhe 2 të ligjit “Për kinematografinë”, duke miratuar të 6 projektet në garë. Fatura e këtij vendimi është shtuar artificialisht me mbi 20 milionë lekë dhe është lehtësisht i konstatueshëm fakti se kemi të bëjmë me abuzim me fondet e buxhetit të shtetit. (detajet në Shtojcën 1).

### **2. Dokumentacion i dyshimtë të konkurseve të zhvilluara në periudhën 19-24 dhjetor 2024**

Për shkak të ngutit për të mbyllur procedurat, si dhe stafit të pakualifikuar që rekturoi në punë jashtë të gjitha kriterëve, **z. Çashku ka nënshkruar nga 2 vendime për secilin vendim të KMP-ve të konkurseve të zhvilluara në muajin 19-24 dhjetor.** Këto vendime janë bërë publike në web dhe nuk dihet cili prej tyre është i saktë. Kjo sepse, vendimet që aktualisht ndodhen në web, nuk përputhen me vendimet e KMP-ve, duke i bërë vendimet e Kryetarit të publikuara në web) të pavlefshme juridikisht. (detajet në shtojcën nr. 2).

### **3. Lejimi i vendimmarrjes konflikt të hapur interesi**

**Vendimi nr. 6, datë 23.12.2024 i KMP të filmit dokumentar, të animuar dhe projekteve të ndryshme kinematografike është marrë në kushte të konfliktit të hapur të interesit.** Kryetari i KMP ka votuar dhe miratuar financimin e projektit për film dokumentar “Braktisja” në kushtet e konfliktit të interesit për të afërmin e tij, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 7, pika 2 të VKM 602, datë 21.08.2003, “Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”.

### **4. Probleme me vendimmarrjen e KMP të filmit dokumentar**

Mbledhja e KMP të filmit dokumentar është zhvilluar në ambientet e QKK në datën 23.12.2024. Në mënyrë të pajustificuar për të njëjtën thirrje dhe për të njëjtat projekte që janë shqyrtuar në një datë, janë marrë 2 vendime:

- Vendimi nr. 6, datë 23.12.2024, i cili ka miratuar 3 projekte nga 3 në konkurim
- Vendimi nr. 7, datë 24.12.2024, i cili ka miratuar 3 projekte nga 3 në konkurim.

**Në fakt, vendimet janë marrë në datën 23.12.2024 dhe vendimmarrja mbledhja është ndarë në mënyrë abuzive, për arsye të pashpjegueshme. Për të vërtetuar këtë mund të konsultohen regjistrimet e mbledhjes së datës 23.12.2024.**



## **5. Zhvillimi i konkurseve në muajin dhjetor 2024 pa kaluar filtrin paraprak të Komisionit Përzgjedhës të Leximit**

Risia që z. Çashku solli në Rregulloren e QKK, megjithë dyshimet tona për implementimin, ishte vënia në funksionim e Komisionit Përzgjedhës të Leximit, i cili përbëhet nga gjashtë anëtarë të propozuar nga shoqatat e kineastëve. **Konkurset e zhvilluara me urgjencë në periudhën 19-24 dhjetor 2024 u zhvilluan pa e kaluar këtë filtër që garanton përzgjedhjen e projekteve cilësore.** Pasi e zhvilloi një procedurë në kundërshtim të plotë me Rregulloren “konstatoi” se nuk kishte kuorum dhe më pas nënshkroi vendimin arbitrar për pezullimin e përkohshëm (por në fakt pa afat) të zbatimit të Kapitullit A.2 të Rregullores. (detaje në shtojcën nr. 3).

## **6. Shkelje e Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë:**

Këshillat e Miratimit të Projekteve, kanë punuar nën presionin e z. Çashku për zhvillimin e mbledhjeve dhe miratimin e projekteve brenda vitit 2024. Projektet janë shpërndarë tek KMP në datën 19 dhjetor dhe kanë patur vetëm 3 ditë në dispozicion (2 prej të cilave ditë fundjave) për të lexuar dhe studiuar 23 projekte. **Ky veprim bie ndesh me përcaktimin e bërë në nënpikën 4, të pikës A.1.4, të Kreut II të Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, nr. 163 Prot., datë 22.05.2024, në të cilën përcaktohet se anëtari i KMP disponon materialet e projekteve të paktën 10 ditë para zhvillimit të mbledhjes së KMP. E githë kjo vendimmarrje e nxituar sigurisht që ka ndikuar edhe në uljen e cilësisë së prodhimeve që janë financuar.**

## **7. Nënshkrimi i kontratave në shkelje të parashikimeve të bëra në Rregullore**

Në mbledhjet e zhvilluara në periudhën 19-23 dhjetor 2024, ku u miratuan 18 projekte **janë nënshkruar të gjitha kontratat duke shkelur nënpikën 1 të Kapitullit IV të Kreut V të Rregullores në 2 raste**, në të cilën parashikohet që producenti mund të nënshkruajë dy kontrata, por nuk mund të financohet për realizimin e dy projekteve në të njëjtën kohë. Nga ky rregull përjashtohen vetëm projektet e kategorisë “Projekte të ndryshme kinematografike” dhe projektet e kategorisë “Koproduksione në Pakicë”.

I nderuar zoti Ministër,

Situata aktuale në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë kërkon një ndërhyrje të menjëhershme. Disfunktionaliteti i institucionit, menaxhimi problematik i burimeve njerëzore dhe financiare, mungesa e transparencës në proceset vendimmarrëse dhe shkeljet e vazhdueshme të akteve ligjore e nënligjore, po rrezikojnë seriozisht jo vetëm mbarëvajtjen e punës së QKK-së, por edhe të ardhmen e kinematografisë shqiptare.

**Duke vlerësuar rolin Tuaj në zhvillimin e sektorit, kërkohet:**

1. Të na mundësoni Ju personalisht takim urgjent me një përfaqësi të komunitetit të kineastëve për të diskutuar së bashku vizionin për të ardhmen e kinematografisë dhe audiovizualit shqiptar.

2. Rivendosjen e funksionalitetit të plotë të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë si institucioni kyç për zhvillimin e kinematografisë shqiptare.

Jemi të bindur se ekspertiza dhe përvoja e komunitetit të kineastëve, së bashku me mbështetjen Tuaj institucionale, do të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në zgjidhjen e këtyre problematikave dhe në forcimin e kinematografisë shqiptare.

Ndërhyrja Juaj në këtë moment kritik është vendimtare për të siguruar jo vetëm mbijetesën, por edhe zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë së filmit në Shqipëri, e cila ka potencialin për të gjeneruar impakt të konsiderueshëm ekonomik për vendin.

Duke shpresuar në mirëkuptimin dhe mbështetjen Tuaj,

Me respekt

**Dionis Papadhimitri**, Kryetar i Shoqatës së Kineastëve të Rinj – Belmond

**Dritan Huqi**, Kryetar i Shoqatës “Albanian Producers and Filmmakers Association”

**Ndriçim Xhepa**, Kryetar i Shoqatës së Kineastëve Shqiptarë

**Pluton Vasi**, Kryetar i Shoqatës “Universal Albanian Cinema”

**Sabina Kodra**, Kryetare e Shoqatës “Albanian Woman in Audiovisual”

Tiranë, më 15.01.2025

## SHTOJCA NR. 1

Projektet e kategorisë Minority Coproduction janë miratuar me vendimin e KMP Nr. 3, datë 24.10.2024. Konform procedurës së përcaktuar në paragrafin e dytë të nenit 7 të ligjit "Për Kinematografinë", vendimi i KMP-së është miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 13, datë 25.10.2024. Nëpërmjet këtyre vendimeve janë miratuar 3 projekte të kësaj kategorie, nga 6 projekte që kishin aplikuar. Fatura financiare e kësaj mbledhje ishte 10.5 milionë lekë.

Me kërkesë të Kryetarit, KMP është mbledhur në datën 20.11.2024 dhe ka rishqyrtuar vendimin e datës 24.10.2024 dhe ka vendosur:

- Të miratojë të 6 projektet e kategorisë Minority Coproduction që kanë aplikuar.
- Të rrisë masën e financimit për të gjitha projektet, bazuar në vlerësimin e Komisionit Financiar të datës 15.10.2024.

Fatura financiare e vendimit të datës 20.11.2024 është afërsisht 31 milionë Lekë. E përkthyer në shifra është 3 herë më e lartë se vendimi i KMP të datës 24.10.2024.

Në Vendimin e KMP të datës 20.11.2024 thuhet se mbledhja është iniciuar nga Kryetari i QKK, i cili ka paraqitur një relacion. Relacioni nuk është publikuar së bashku me vendimin e KMP, si detyrim për transparencë. Kjo vendimmarrje është justifikuar referuar Nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative (Ligji Nr. 44/2015). Kthimi i vendimit të KMP-së është i pambështetur ligjërisht dhe krijon një precedent të rrezikshëm administrativ. Arsyetimi për këtë qëndrim mbështetet në dy shtylla kryesore:

**Së pari**, kushtet ligjore për rishikim sipas nenit 144 nuk plotësohen në këtë rast. Ky nen parashikon që rishikimi mund të kërkohet vetëm kur:

- a) zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë;
- b) këto rrethana kanë rëndësi për çështjen;
- c) këto rrethana nuk dihen dhe nuk mund të dihen gjatë procedurës administrative.

**Së dyti**, vendimi i Kryetarit për kthimin e projekteve të kategorisë Minority Co-production (Vendimi nr. 3/1 datë 20.11.2024) paraqet problematika serioze:

- Krijon një precedent antiligjor duke miratuar të gjitha 6 projektet në garë;
- Shkel në mënyrë flagrante nenin 9, paragrafët 1 dhe 2 të ligjit "Për kinematografinë";
- Rrit artificialisht faturën me mbi 20 milionë lekë;
- Përbën abuzim të qartë me fondet e buxhetit të shtetit.

Për rrjedhojë, ky vendim konsiderohet i pambështetur ligjërisht pasi nuk përmbush asnjë prej kushteve të nenit 144 për rishikim dhe njëkohësisht krijon pasoja negative për administratën publike dhe fondet buxhetore.

## **SHTOJCA NR. 2**

### **VENDIMET E KRYETARIT TE DUBLUARA**

[shqiptarja.com]



QKK QENDRA  
KOMBËTARE E  
KINEMATOGRAFISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYETARI

Nr. 506/1 Prot.

Datë 24.12.2024

VENDIM

Nr. 21, Datë 24.12.2024

**“PËR MIRATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MIRATIMIT TË  
PROJEKTEVE TË FILMIT DOKUMENTAR, TË ANIMUAR DHE  
PROJEKTEVE TË NDRYSHME KINEMATOGRAFIKE NR. 6, DATË  
23.12.2024”**

Në zbatim të paragrafit të dytë të Nenit 7, si dhe paragrafit të parë të Nenit 9, të Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”, të ndryshuar, paragrafit të dytë të nenit 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 21.08.2003, “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, të ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të QKK, nr. 163 Prot., datë 22.05.2004, Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve, Vendimit të Këshillit të Miratimit të Projekteve nr. 6, datë 23.12.2024, si dhe vlerësimit të Komisionit Financiar;

V E N D O S A:

I. Të miratoj financimin e projekteve në kategorinë Film Dokumentar

- **Projekti “Braktisja ”**, paraqitur nga Producenti Eda Gemi p.f., skenari Ylljet Aliçka, regjia Enxhi Arapi. Vlera e financimit të jetë në masën **2.227.500(dy milion e dyqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind) Lekë.**
- **Projekti “Nikolla i zemrës së Tiranës”**, paraqitur nga Producenti Steljo Gaçe p.f., skenari Natasha Lako, regjia Mevlan Shanaj. Vlera e financimit të jetë në masën **3.000.000 (tre milionë) Lekë.**
- **Projekti “Një princeshë Europiane”** paraqitur nga Producenti Ajola Daja p.f., skenari Martin Cukalla, regjia Ylli Pepo Vlera e financimit të jetë në masën **2.945.000(dy milionë e nëntëqind e dyzetë e pesë mijë) Lekë.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Përgatiti: E.Cara, Juriste  
Miratoi: G.Gjergji, Drejtore  
Rruga Aleksandër Moisiu 77, Kinostudio  
1005 Tirana, Shqipëri



KRYETARI

Eol ÇASHKU

+355 4 23 78 004

[info@qkk.gov.al](mailto:info@qkk.gov.al) - [www.qkk.al](http://www.qkk.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË  
KRYETARI

№ 506/1 Prot.

Datë 24 / 12 / 2024

V E N D I M

№ 24, datë 24 / 12 / 2024

«PËR MIRATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT MIRATUES TË PROJEKTEVE  
TË FILMIT DOKUMENTAR, TË ANIMUAR DHE PROJEKTEVE  
TË NDRYSHME KINEMATOGRAFIKE, №6, DATË 23.12.2024»

Në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 7, neneve 8 dhe 9, të ligjit me №8096, datë 21.03.1996, «Për kinematografinë», të ndryshuar, paragrafit të dytë të nenit 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave №602, datë 21.08.2003, «Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë», të ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë me №163 prot., datë 22.05.2004, Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve (të ndryshuar) me №168 prot., datë 27.05.2024, Vendimit të Këshillit Miratues të Projekteve të Filmit Dokumentar, të Animuar dhe Projekteve të Ndryshme Kinematografike me №6, datë 23.12.2024, si dhe vlerësimit të Komisionit Financiar,

V E N D O S A :

Të miratoj financimin e këtyre projekteve në kategorinë film dokumentar:

- **Projekti «Braktisja»**, skenari Ylljet Aliçka, regjia Enxhi Arapi, paraqitur nga shtëpia kinematografike TEOFILM sh.p.k., me producente Eda Gemi. Vlera e financimit është **2.227.500 (dy milion e dyqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë.**
- **Projekti «Nikolla i zemrës së Tiranës – Nikolla Zoraqi»**, skenari Natasha Lako, regjia Mevlan Shanaj, paraqitur nga shtëpia kinematografike Production Cinemania, me producent Steljo Gaçe p.f.. Vlera e financimit është **3.000.000 (tre milion) lekë.**
- **Projekti «Një princeshë evropiane»**, skenari Martin Cukalla, regjia Ylli Pepo, paraqitur nga shtëpia kinematografike A.R. Production, me producente Ajola Daja p.f.. Vlera e financimit është **2.945.000 (dy milion e nëntëqind e dyzet e pesë mijë) lekë.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.







QENDRA  
KOMBËTARE E  
KINEMATOGRAFISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYETARI

Nr. 508/2 Prot.

Datë 24.12.2024

VENDIM

Nr. 22, Datë 24.12.2024

**“PËR MIRATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MIRATIMIT TË  
PROJEKTEVE TË FILMIT DOKUMENTAR, TË ANIMUAR DHE  
PROJEKTEVE TË NDRYSHME KINEMATOGRAFIKE NR. 7, DATË  
24.12.2024”**

Në zbatim të paragrafit të dytë të Nenit 7, si dhe paragrafit të parë të Nenit 9, të Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”, të ndryshuar, paragrafit të dytë të nenit 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 21.08.2003, “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, të ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të QKK, nr. 163 Prot., datë 22.05.2004, Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve, Vendimit të Këshillit të Miratimit të Projekteve nr. 7, datë 24.12.2024, si dhe vlerësimit të Komisionit Financiar;

**V E N D O S A:**

I. Të miratoj financimin e projekteve në kategorinë Film Dokumentar

- **Projekti “Jeta si një film Piro Milkani”**, paraqitur nga Producenti Bashkim Hoxha p.f., skenari Bashkim Hoxha, regjia Rigers Plaka. Vlera e financimit të jetë në masën **2.715.000 (dymilionë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lekë**
- **Projekti “Përtej tolerancës”** paraqitur nga Producenti Eliodor Markaj p.f., skenari dhe regjia Fabian Kati Vlera e financimit të jetë në masën **2.930.000 (dy milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë) Lekë**
- **Projekti “Vizita”** paraqitur nga Producenti Eljodor Markaj p.f., skenari dhe regjia Eljodor Markaj Vlera e financimit të jetë në masën **3.007.600 (tre milionë e shtatë mijë e gjashtëqind) Lekë**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Përgatiti: E.Cara, Juriste  
Miratoi: G.Gjergji, Drejtore  
Rruga Aleksandër Moisiu 77, Kinostudio  
1005 Tirana, Shqipëri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË  
KRYETARI

№ 508/2 Prot.

Datë 24 / 12 / 2024

V E N D I M

№ 22, datë 24 / 12 / 2024

« PËR MIRATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT MIRATUES TË PROJEKTEVE  
TË FILMIT DOKUMENTAR, TË ANIMUAR DHE PROJEKTEVE  
TË NDRYSHME KINEMATOGRAFIKE, №7, DATË 24.12.2024 »

Në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 7, neneve 8 dhe 9, të ligjit me №8096, datë 21.03.1996, «Për kinematografinë», të ndryshuar, paragrafit të dytë të nenit 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave №602, datë 21.08.2003, «Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë», të ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë me №163 prot., datë 22.05.2004, Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve (të ndryshuar) me №168 prot., datë 27.05.2024, Vendimit të Këshillit Miratues të Projekteve të Filmit Dokumentar, të Animuar dhe Projekteve të Ndryshme Kinematografike me №7, datë 24.12.2024, si dhe vlerësimit të Komisionit Financiar,

V E N D O S A :

Të miratoj financimin e këtyre projekteve në kategorinë film dokumentar:

• **Projekti «Jeta si një film – Piro Milkani»**, skenari Bashkim Hoxha, regjia Rigers Plaka, paraqitur nga shtëpia kinematografike CINEMANIA, me producent Jaklid Gaçe p.f.. Vlera e financimit është **2.715.000 (dy milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.**

• **Projekti «Përtej tolerancës»**, skenari dhe regjia Fabian Kati, paraqitur nga shtëpia kinematografike EMBLEM, me producent Eliodor Markja p.f.. Vlera e financimit është **2.930.000 (dy milion e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë.**

• **Projekti «Vizita»**, skenari dhe regjia Ardit Sadiku, paraqitur nga shtëpia kinematografike Ardit Sadiku Film sh.p.k., me producent Ardit Sadiku. Vlera e financimit është **3.007.600 (tre milion e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EOL ÇASHKU





QKK QENDRA  
KOMBËTARE E  
KINEMATOGRAFISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYETARI

Nr. 510/1 Prot.

Datë 24.12.2024

VENDIM

Nr. 23, Datë 20.12.2024

**“PËR MIRATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MIRATIMIT TË  
PROJEKTEVE TË KËSHILLI MIRATUES I PROJEKTEVE TË FILMIT**

**ARTISTIK  
NR. 4, DATË 24.12.2024”**

Në zbatim të paragrafit të dytë të Nenit 7, si dhe paragrafit të parë të Nenit 9, të Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”, të ndryshuar, paragrafit të dytë të nenit 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 21.08.2003, “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, të ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të QKK, nr. 163 Prot., datë 22.05.2004, Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve, Vendimit të Këshillit të Miratimit të Projekteve nr. 4, datë 24.12.2024, si dhe vlerësimit të Komisionit Financiar;

V E N D O S A:

- I. Të miratoj financimin e projekteve në kategorinë Film Artistik me Metrazh të Shkurtër
- Projekti “ **Kolltuku**”, paraqitur nga Producenti Robert Budina p.f.,skenari Enxhi Rista, regjia Enxhi Rista. Vlera e financimit të jetë në masën **2.800.000(dy milionë e tetëqind mijë)Lekë**
  - Projekti “**Sofia nga Jugosllavia**” paraqitur nga Producenti Lorina Pepo p.f.,skenari Sokol Keraj, regjia Sokol Keraj. Vlera e financimit të jetë në masën **2.700.000(dy milionë e shtatëqind mijë)Lekë**
  - Projekti “**Njëri nga ne**” paraqitur nga Producenti Belina Jano p.f.,skenari Ervin Kotori, regjia Ervin Kotori. Vlera e financimit të jetë në masën **2 .000.000(dy milionë)Lekë**
  - Projekti “**Valixhe**” paraqitur nga Producenti Ajola Daja p.f.,skenari Ajola Daja, regjia Adi Guri. Vlera e financimit të jetë në masën **1.600.000(një milionë e gjashtëqind mijë)Lekë**

- Projekti “**Kamioni i bardhë**” ,paraqitur nga Producenti Mateo Cingu p.f., skenari Fabio Seferi , regjia Fabio Seferi. Vlera e financimit të jetë në masën 1.400.000( **një milionë e katërqind mijë**)Lekë

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Eol ÇASHKU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË  
KRYETARI

№ 510/1 Prot.

Datë 24 / 12 / 2024

V E N D I M

№ 23, datë 24 / 12 / 2024

«PËR MIRATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT MIRATUES  
TË PROJEKTEVE TË FILMIT ARTISTIK, №4, DATË 24.12.2024»

Në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 7, neneve 8 dhe 9, të ligjit me №8096, datë 21.03.1996, «Për kinematografinë», të ndryshuar, paragrafit të dytë të nenit 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave №602, datë 21.08.2003, «Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë», të ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë me №163 prot., datë 22.05.2004, Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve (të ndryshuar) me №168 prot., datë 27.05.2024, Vendimit të Këshillit Miratues të Projekteve të Filmit Artistik me №4, datë 24.12.2024, si dhe vlerësimit të Komisionit Financiar,

V E N D O S A :

Të miratoj financimin e këtyre projekteve në kategorinë film artistik me metrazh të shkurtër:

• **Projekti «Kolltuku»**, skenari dhe regjia Enxhi Rista, paraqitur nga shtëpia kinematografike ERA FILM sh.p.k., me producent Robert Budina. Vlera e financimit është **2.800.000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë.**

• **Projekti «Sofia nga Jugosllavia»**, skenari dhe regjia Sokol Keraj, paraqitur nga shtëpia kinematografike SOFILMS sh.p.k., me producente Lorina Pepo. Vlera e financimit është **2.700.000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë.**

• **Projekti «Njëri si ne»**, skenari dhe regjia Ervin Kotori, paraqitur nga shtëpia kinematografike Animated Society sh.p.k., me producente Belina Jano. Vlera e financimit është **2.000.000 (dy milion) lekë.**

• **Projekti «Valixhe»**, skenari Ajola Daja, regjia Adrian Guri, paraqitur nga shtëpia kinematografike A.R. Production, me producente Ajola Daja p.f.. Vlera e financimit është **1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë.**



• **Projekti «Kamioni i bardhë»**, skenari dhe regjia Fabio Seferi, paraqitur nga shtëpia kinematografike Makers Production sh.p.k., me producent Mateus Çingi. Vlera e financimit është **1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekë**.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EOL ÇASHKU**



Konceptoi: E. Cara

Miratoi: G. Gjergji



**SHTOJCA NR. 3**

[shqiptarja.com]



QENDRA  
KOMBËTARE E  
KINEMATOGRAFISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prot: 500/1  
Tiranë, Dt. 20 Dhjetor 2024

**KRYETARI**

**VENDIM**

Nr. 19, Datë 20.12.2024

**PËR KONSTATIMIN E PAVLEFSHMËRISË SË PROCEDURËS SË  
MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËRZGJEDHËS TË LEXIMIT DATË  
20.12.2024**

Në mbështetje të Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996 "Për Kinematografinë";  
Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së  
Shqipërisë", neni 108 e vijues; Rregullores së Brendshme të Organizimit  
dhe Funkcionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, kapitulli A.2  
e vijues,

**VENDOSA**

1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të procedurës së ndjekur për krijimin e Komisionit Përzgjedhës të Leximit, të kryer në datën 20.12.2024;
2. Çdo dokument i prodhuar nga kjo mbledhje do të konsiderohet nul;
3. Marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria e Projekteve për njoftimin e palëve të interesuara.

Kryetari

Eol Çashku





QENDRA  
KOMBËTARE E  
KINEMATOGRAFISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 500/2 Prot.,

Tiranë, më 20. 12.2024

## RELACION

### PËR KONSTATIMIN E PAVLEFSHMËRISË SË PROCEDURËS SË MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËRZGJEDHËS TË LEXIMIT TË DATËS 20.12.2024

I Nderuar Z. Kryetar,

Sikurse jeni në dijeni, në datën 20.12.2024 është mbajtur mbledhja e Komisionit Përzgjedhës të Leximit për sa i përket projekteve konkurruese.

Me vendimin tuaj nr. 19, date 20.12.2024 keni konstatuar se procedura e zhvilluar për KPL në kuadër të shqyrtimit të projekteve, ka qënë e pavlefshme për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm për hedhjen e shortit.

Në kushtet kur një anëtare e komisionit ka njoftuar mospjesëmarrjen në proces për shkak të konfliktit të interesit dhe dy anëtarët e tjerë tashmë kanë marrë dijeni mbi projektet që kaluan në këtë komision, numri i anëtarëve të mbetur nuk lejon hedhjen e shortit sërish, duke bërë të pamundur zhvillimin e procedurës konform Rregullores së Brendëshme, paragrafi A.2.3, pika 3.

Grejs Gjergji

Emanuela Cara

Kozeta Kullakshi



QENDRA  
KOMBËTARE E  
KINEMATOGRAFISË

**KRYETARI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prot:

500/B  
Tiranë, Dt. 20 Dhjetor 2024

**VENDIM**

Nr. 20, Datë 20.12.2024

**MBI PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË ZBATIMIT TË KAPITULLIT  
A.2 TË RREGULLORES SË BRENDSHME TË ORGANIZIMIT DHE  
FUNKSIONIMIT TË QKK**

Në mbështetje të Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për Kinematografinë” të ndryshuar; Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 180 e vijues; Rregullore së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë; Relacionit me nr. prot. 500/B datë 20.12.2024, me qëllim vijimin e procedurës së miratimit të projekteve kinematografike që i janë paraqitur QKK-së për mbështetje financiare,

**VENDOSA**

1. Pezullimin e zbatimit të neneve respektive të Kapitullit A.2, të Rregullore së Brendshme, që lidhen me funksionimin e Komisionit Përzgjedhës të Leximit, për shkak të pamundësisë së krijimit dhe funksionimit të tij për mungesë quorumi;
2. Të merren masat e nevojshme që të gjitha projektet t’i kalojnë për miratim Këshillave të Miratimit të Projekteve.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Projekteve.

Kryetari

Eol Cashku

